



NJOFTIM PER DEGJESE PUBLIKE

Shell Upstream Albania B.V (SUA) është operatori i Kontratës me Ndarje Prodhimi (KNP) për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e naftës në Blloqet 2-3 në tokë, Shqipëri, ku aktualisht po kryen aktivitete vlerësimi. Së fundmi, SUA ka nënshkruar një KNP për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e naftës në Bllokun 4, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.350 datë 12.06.2018.

Si pjesë e planit të operacioneve në kuadër të KNP, SUA planifikon kryerjen e vrojtimeve sizmike 2D në Bllokun 4, me zgjatim të linjave në Blloqet 2-3. Projekti shtrihet në teritorrin e Qarkut të Gjirokastrës dhe do të zbatohet gjatë vitit 2019. Në zbatim të legjislacionit Shqiptar dhe standarteve të kompanisë Shell, aktualisht projekti është në procesin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor, Social dhe në Shëndet (VNMSSH). Sa më sipër, në zbatim të VKM nr. 247 datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore” njoftojmë se projekti është në fazën e informimit publik dhe palëve të interesit për zhvillimin e degjesave publike sipas programit të mëposhtem.

Nr	Data	Ora	Vendi i takimit	Bashkia	Njesite administrative (NJA) dhe fshatrat ku shtrihet projekti
1	08.01.2019	10:00-12:00	Hotel Çajupi, Salla e Konferencave	Gjirokaster Libohove Dropull Tepelene Memaliaj	Bashkite Gjirokaster, Libohove, Dropull, Tepelene, Memaliaj Drejtorite rajonale OJF, komunitet
2	08.01.2019	14:00– 15:00	NJA Lunxheri, Salla e mbledhjeve	Gjirokaster	NJA Lunxheri Fshati Topullaraj
3	09.01.2019	9:30 – 11:00	Qendra Multikulturore Permet	Permet Kelcyre	Bashkite Permet dhe Kelcyre Institucionet vendore Fshati: Lipe e vjeter OJF, komunitet
4	09.01.2019	13:00 –14:00	Shkolla 9-vjecare “At Stath Melani”	Permet	NJA Petran Fshatrat: Badelonje, Leshnice, Kaludh, Leuse
5	10.01.2019	10:00 – 11:00	NJA Qender Piskove, Salla e mbledhjeve	Permet	NJA Qender Piskove Fshatrat: Rapcke, Buali, Mokrice- Zelusha
6	10.01.2019	13:30 – 14:30	Bashkia Kelcyre, Salla e mbledhjeve	Kelcyre	Bashkia Kelcyre NJA Dishnice Beduqas, Riban, Brezhdani (Rreza), Fratar
7	11.01.2019	10:00 – 12:00	Qendra Kulturore Tepelene	Tepelene	Bashkia Tepelene NJA Qender Tepelene

					Fshatrat: Hormove, Mezhegoran, Peshtan, Luar, Dragot, Lekel
8	14.01.2019	10:30 – 11:30	Bashkia Memaliaj, Salla e mbledhjeve	Memaliaj	Bashkia Memaliaj NJA Qender Memaliaj Fshatrat: Cerrile, Dames, Kashisht, Kallemb, Bylysh
9	14.01.2019	14:00 – 15:00	Shkolla ne Arshi Lengo	Gjirokaster	NJA Antigone Fshati Arshi Lengo
10	15.01.2019	10:00 – 11:00	NJA Cepo, Salla e mbledhjeve	Gjirokaster	NJA Cepo, NJA Picar Fshatrat: Plesat, Humelice, Palokaster, Cepune, Kardhiq, Picar
11	15.01.2019	14:00 – 15:00	Bashkia Libohove, Salla e mbledhjeve	Libohove	Bashkia Libohove, NJA Qender Libohove Fshati Bulo
12	16.01.2019	9:30 – 10:30	NJA Pogon, Salla e mbledhjeve	Dropull	Bashkia Dropull NJA Pogon Fshati Polican
13	16.01.2019	12:00 – 13:30	NJA Zagorie, Salla e mbledhjeve	Libohove	NJA Zagorie Fshatrat: Doshnicë, Nderan Topovë, Hoshtevë, Liar
14	17.01.2019	10:00 – 11:00	Shkolla Zhapokike	Memaliaj	NJA Luftinje Fshati Zhapokike

Në dëgjesat publike do të prezantohen rezultatet e VNMSH dhe masat që do të zbatohen për mbrojtjen e mjedisit fizik, social dhe trashëgimisë kulturore. Gjithashtu do të merren sugjerimet dhe mendimet e të pranishmëve në këto takime.

Plani i zhvillimit të dëgjesave është dakordësuar, me njësitë administrative dhe Bashkitë si dhe është dorëzuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Përmbledhja në gjuhë jo teknike e Raportit VNMSH gjendet e publikuar ne faqen elektronike te AKM-së (www.akm.gov.al). Kopje të njoftimeve për degjesat janë ekspozuar ne zyrat e Njësive Vendore dhe këndet informuese të Bashkive. Kopje të printuara të materialeve të degjesës janë dërguar dhe janë të disponueshme në zyrat e Bashkive dhe Njesive Administrative ku do te mbahen degjesat si dhe ne në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit, Gjirokastër. Publikimi i Draft Raportit të VNM gjendet: <https://www.shell.al/>

Çdo person apo palë e interesuar mund të konsultohet paraprakisht me materialet dhe të japë mendimet e sugjerimet e tij për ndikimet mjedisore e sociale të projektit si dhe masat zbutese pranë kontaktit te AKM-se (info@akm.gov.al); kontakteve te Oficerit për Marëdhëniet me Komunitetin pranë Shell Upstream Albania B.V; Lindita Luzo, Posta elektronike: Lindita.Luzo@shell.com dhe telefon: 0697046781 si dhe mund të dërgohen të shtypura në zyrat e Shell Upstream Albania B.V në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”; European Trade Center (ETC), Kati 5-të,Tiranë, Albania. Mendimet apo sugjerimet mund të dërgohen brenda datës 7 Janar 2019.

Jane të ftuar të marrin pjese në këto takime, komunitetet e fshatrave përgjatë të cilëve do të kryhen operacionet e vrojtimit sizmik, komuniteti i zonës që ka interes për t’u informuar si dhe cdo palë tjetër e interesuar për zbatimin e ketij projekti.